



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP),

Në mbështetje të neneve 1, 2, 5, 6, 8, 9, 15.2.1 dhe 15.2.12 të Ligjit të AKP-së,

Në mbështetje të Politikave Operative të Agjencisë,

Miraton:

**RREGULLOREN NR. 06/2023 PËR
RREGULLAT E PËRGJITHSHME TË TENDERIT**

28 shtator 2023

PËRMBAJTJA

Neni 1 Qëllimi.....	1
Neni 2 Përkufizimet.....	1
Neni 3 Vlefshmëria juridike dhe interpretimi i Rregullave të Tenderit.....	7
Neni 4 Aspekte të përgjithshme mbi procesin e shitjes.....	7
Neni 5 Ofertuesit me ndalesë ofertimi.....	9
Neni 6 Hulumtimi paraprak dhe marrja e dokumenteve të tenderit.....	10
Neni 7 Tarifa për dorëzimin e ofertës dhe depozita e ofertës.....	12
Neni 8 Përmbajtja dhe dorëzimi i ofertave.....	12
Neni 9 Hapja e ofertave.....	14
Neni 10 Procedurat e verifikimit.....	15
Neni 11 Shpallja e fituesit të përkohshëm dhe pagesa e çmimit të blerjes.....	16
Neni 12 Klasifikimi i ofertave me çmime të njëjta.....	19
Neni 13 Modifikimi dhe tërheqja e ofertave.....	19
Neni 14 Aprovimi dhe refuzimi i ofertave për asetet/subjektet e reja të tenderuara.....	19
Neni 15 Kontrata e shitjes.....	20
Neni 16 Rezervimi i të drejtave nga ana e Agjencisë.....	22
Neni 17 Dispozitat kalimtare.....	23
Neni 18 Hyrja në fuqi.....	23
SHTOJCA A - "ORARI I TENDERIT".....	25
SHTOJCA B - FORMULARI PËR DORËZIMIN E OFERTËS - PASQYRA E ÇMIMIT -	26

Neni 1 Qëllimi

Me këto rregulla të tenderit përcaktohen procedurat për privatizimin e “subjekteve të reja” dhe për shitjen e “asetit të tenderuar” përmes likuidimit, siç janë definuar me këto rregulla të tenderit, duke përfshirë kushtet dhe kriteret për paraqitjen e ofertave nga ana e ofertuesve, kushtet dhe kriteret për klasifikimin dhe përzgjedhjen e ofertave nga ana e Agjencisë si dhe kushtet e kriteret për lidhjen e kontratave të shitjes me ofertuesit fitues të përkohshëm.

Neni 2 Përkufizimet

Përkufizimet në vijim do të zbatohen në këto rregulla tenderi përveç në rastet ku sipas kontekstit kërkohet ndryshe:

1. **“Agjencia”** nënkupton Agjencinë Kosovare të Privatizimit (këtej e tutje “Agjencia”) e cila ushtron mandatin e saj në përputhje me Ligjin Nr.04/L-034¹, me plotësime, mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit (“Ligji”).
2. **“Asetet e tenderuara”** nënkupton pasuritë e luajtshme dhe/ose të paluajtshme të NSH-së, hollësitë e të cilave janë të dhëna në memorandumun e informatave, të cilat tenderohen për shitje në pajtim me rregullat e tenderit.
3. **“Bordi”** nënkupton Bordin e Drejtorëve të Agjencisë.
4. **“Çmimi i ofertës”** nënkupton shumën e ofertës së paraqitur në euro (€) nga ofertuesi për privatizimin e aksioneve të subjektit të ri apo asetin e tenderuar.
5. **“Data e pranimit të njoftimit”** nënkupton datën e veprimit të ndërmarrë nga ana e personelit të caktuar të Agjencisë, me qëllim të njoftimit/kontaktimit të palës përmes letrës, telefonit, faxit apo postës elektronike.
6. **“Depozita e ofertës”** nënkupton shumën financiare e cila caktohet nga Agjencia, në baza individuale për secilën njësi apo pasuri që vihet në tenderim, e cila deponohet nga ofertuesit në pajtim me nenin 7.2 të Rregullave të Përgjithshme të Tenderit.
7. **“Detyrimet rrjedhëse”** nënkupton disa borxhe dhe detyrime të caktuara të NSH-së, të cilat transferohen te subjekti i ri e qe janë krijuar gjatë afarizmit të zakonshëm të NSH-së dhe të cilat

¹Ligji Nr. 04/L-034 ka hyrë në fuqi më 21.09.2011, shpallur në Gazetën Zyrtare 19/2011, e ka shfuqizuar Ligjin Nr. 03/L-067.

janë paraqitur si ilustrim në një listë në memorandumit e informatave dhe informatat e tyre janë të përfshira në zyrën e të dhënave dhe të cilat përfshijnë si në vijim:

- 7.1. Detyrimet neto të NSH-së për TVSh, ku përjashtohen kamatat dhe gjobat, të cilat janë shfaqur gjatë periudhës prej 12 muajve para datës së hyrjes në fuqi të kontratës;
 - 7.2. Detyrimet e papaguara të NSH-së për tatimin mbi pronë, në lidhje me pronën e paluajtshme që përbën artikujt e tenderuar, e që janë shfaqur gjatë periudhës prej 12 muajve para datës së hyrjes në fuqi të kontratës;
 - 7.3. Detyrimet e NSH-së për mallra dhe shërbime (p.sh. borxhet ndaj KEK-ut apo për shërbimet tjera publike apo borxhet ndaj furnizuesve, mirëpo duke mos përfshirë pagat, pensionet ose pagesat tjera ndaj apo në emër të punonjësve të NSH-së në kapacitetin e tyre si punonjës), që janë shfaqur gjatë periudhës prej 3 muajve para datës së hyrjes në fuqi të kontratës.
 - 7.4. Kosto e furnizimit të mallrave dhe shërbimeve (duke mos i përfshirë pagat, pensionet ose pagesat tjera për ose në emër të punëtorëve të NSH-së në kapacitetin e tyre si punëtorë) e mbledhur gjatë rrjedhjes normale të biznesit që:
 - 7.4.1. Është mbledhur gjatë periudhës tre mujore që përfundon në datën kur deklarata relevante e transferit ka hyre në fuqi;
 - 7.4.2. Që mbetet e papaguar deri në atë datë dhe i ngarkohet biznesit të NSH-së.
 - 7.5. Çfarëdo detyrime tjera që transferohen nga NSH-ja në subjektin e ri, e të cilat janë identifikuar në memorandumit e informatave (ose në çfarëdo azhurnimi të atij dokumenti) ose në zyrën e të dhënave.
8. **“Ditë pune”** nënkupton ditët në të cilët punojnë institucionet publike të Republikës së Kosovës, përveç të shtunave dhe të dielave si dhe ditëve të cilat me ligjin në fuqi janë të caktuara si festa zyrtare.
 9. **“Dokumentet e tenderit”** nënkuptojnë: (1) Njoftimin për Tender; (2) Memorandumit e Informatave (siç është përshkruar më poshtë në këtë nen), (3) Rregullat e Tenderit; (4) Dosjen elektronike, (5) një deklaratë për ruajtjen e sekretit afarist për t’u nënshkruar nga ofertuesit dhe Agjencia, dhe dokumentet e tjera të cilat Agjencia mund t’i vlerësoj si të nevojshme.
 10. **“Dosja Elektronike”** nënkupton dosjen elektronike të themeluar nga Agjencia ku vendosen në dispozicion disa informata dhe dokumente në lidhje me NSH-në, subjektin e ri apo asetit e tenderuar për t’u inspektuar nga ofertuesit.

11. **“Dhoma e Posaçme”** nënkupton Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës e themeluar në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut, “mbi themelimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për Çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit”, e zëvendësuar me Ligjin në fuqi për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, për çështjet e ndërlidhura me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.
12. **“Formulari për dorëzimin e ofertës dhe Pasqyra e çmimit”** nënkupton dokumentin, i cili ka formën e përcaktuar në Shtojcën B, që dorëzohet nga secili ofertues në pajtim me nenin 8.7 të kësaj rregullore.
13. **“Komisionet”** nënkupton komisionet e themeluara sipas kësaj rregullore. Anëtarët e komisioneve emërohen nga Menaxhmenti i Agjencisë. Detyrat e këtyre komisioneve do të caktohen me vendim për emërim sipas dispozitave të kësaj rregullore. Komisioni do të përbëhet prej së paku 3 anëtarëve. Anëtarët e komisioneve nuk mund të shërbejnë në më shumë se një komision. Anëtarët e komisioneve do të nënshkruajnë deklaratën mbi ruajtjen e konfidencialitetit sipas ligjit të AKP-së dhe dispozitat tjera ligjore.
14. **“Komisioni për hapjen e ofertave”** nënkupton komisionin e themeluar nga Menaxhmenti i Agjencisë, autorizimet e të cilit janë të përcaktuara me nenin 9 të kësaj rregullore.
15. **“Komisioni për pranimin e ofertave”** nënkupton komisionin e themeluar nga Menaxhmenti i Agjencisë, autorizimet e të cilit janë të përcaktuara me nenin 8.6, 8.8 dhe 8.9 të kësaj rregullore.
16. **“Komisioni vlerësues”** është komision i emëruar nga Menaxhmenti i Agjencisë për shqyrtimin e dokumenteve të dorëzuara nga ofertuesit me ofertën më të lartë, autorizimet e të cilit janë përcaktuar me nenin 10 të kësaj rregullore.
17. **“Komisioni i shkallës së dytë”** është komision i emëruar nga Menaxhmenti i Agjencisë, për shqyrtimin e ankesave kundër vendimeve të përcaktuara me nenin 8.6 të Rregullave të Tenderit. Përbërja e këtij Komisioni do të jetë nga niveli i mesëm drejtues i Agjencisë (Drejtorë të Departamenteve relevante).
18. **“Komisioni për regjistrimin e ofertave”** nënkupton komisionin e themeluar nga Menaxhmenti i Agjencisë i cili bën vendosjen e ofertave në formën tabelare në Ditën e Shitjes apo Ceremoninë e hapjes së ofertave, sipas nenit 9.3 të kësaj rregullore.
19. **“Komisioni verifikues i ofertave”**, nënkupton komisionin e themeluar nga Menaxhmenti i Agjencisë, sipas nenit 8.11 të kësaj rregullore.

20. **“Kontrata e shitjes”** nënkupton kontratën e lidhur ndërmjet ofertuesit fitues të përkohshëm dhe Agjencisë (ku Agjencia vepron në emër të NSH-së) sipas së cilës subjekti i ri apo aset i tenderuar i shiten ofertuesit fitues të përkohshëm duke pasur parasysh që Agjencisë i paguhet çmimi i ofertës më të lartë.
21. **“Regjistri i ofertuesve”** nënkupton regjistrin e ofertuesve i cili përpilohet dhe mirëmbahet nga Agjencia.
22. **“Ligji në fuqi”** nënkupton ligjet dhe aktet nënligjore të miratuara në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin që është në fuqi.
23. **“Memorandumi i informatave”** nënkupton dokumentin e përgatitur nga Agjencia i cili përmban informacione të ndryshme për NSH-në, subjektin e ri apo asetin e tenderuar, duke përfshirë: paraqitjen e një historiku të shkurtër të NSH-së; përmbledhjen e aktivitetit afarist të saj; paraqitjen e pasurisë kyçe të saj; një përshkrim të asetit të tenderuar; si dhe informacionet e tjera që konsiderohen si të rëndësishme, nga ana e personelit të Agjencisë. Memorandumi i Informatave ka vetëm natyrë informative dhe si i tillë nuk paraqet ofertë.
24. **“Menaxhmenti”** nënkupton Drejtorin Ekzekutiv dhe dy Zëvendës Drejtorët Ekzekutiv të Agjencisë, kolektivisht dhe individualisht.
25. **“Ndërmarrje”** nënkupton ndërmarrjen ashtu siç është definuar me nenin 5 të Ligjit për Agjencinë, mbi të cilën Agjencia ushtron autoritetin e saj administrativ.
26. **“Njoftimi për tender”** nënkupton njoftimin e publikuar nga Agjencia përmes të cilit shpallet tenderi dhe ku ofrohen hollësitë specifike të tenderit.
27. **“Njoftimi për pagesë”** nënkupton njoftimin nga Agjencia drejtuar ofertuesit fitues të përkohshëm për pagesën e çmimit të ofruar.
28. **“NSH-ja”** nënkupton ndërmarrjen shoqërore.
29. **“Oferta”** nënkupton shprehjen e vullnetit të një personi apo subjekti, e cila i paraqitet Agjencisë (të cilës i bashkëngjiten dëshmitë siç është përcaktuar me nenin 8.6 të Rregullave të Tenderit, duke përfshirë por duke mos u kufizuar me çmimin e ofertës), e cila dorëzohet sipas kritereve të përcaktuara me nenin 8 të kësaj rregullore, qëllimi i së cilës është pjesëmarrja në tender për blerjen e subjektit të ri apo asetit të tenderuar.

30. **“Oferta me çmimin më të lartë”** nënkupton ofertën me të cilën ofrohet çmimi më i lartë, për blerjen e subjektit të ri apo asetit të tenderuar.
31. **“Ofertuesi”** nënkupton çdo person fizik, juridik, shoqëri tregtare apo korporatë që ka dorëzuar ofertë.
32. **“Ofertuesi fitues i përkohshëm”** nënkupton cilido nga ofertuesit më të lartë, ofertuesi i dytë më i lartë, ofertuesi i tretë më i lartë respektivisht, të cilin e njofton Agjencia me shkrim se është shpallur si fitues i përkohshëm.
33. **“Ofertuesi më i lartë”** nënkupton ofertuesin i cili në procesin e tenderimit të subjektit të ri apo asetit të tenderuar, dorëzon ofertën me çmimin më të lartë.
34. **“Ofertuesi i dytë më i lartë”** nënkupton ofertuesin i cili në procesin e tenderimit renditet i dyti për nga lartësia e çmimit të ofruar, për blerjen e subjektit të ri apo asetit të tenderuar.
35. **“Ofertuesi i tretë më i lartë”** nënkupton ofertuesin i cili në procesin e tenderimit renditet i treti për nga lartësia e çmimit të ofruar, për blerjen e subjektit të ri apo asetit të tenderuar.
36. **“Ofertuesi i mundshëm”** nënkupton çdo person fizik, juridik, shoqëri tregtare apo korporatë, në çdo fazë para dorëzimit të ofertës.
37. **“Ofertuesi me ndalesë”** nënkupton çdo person fizik, juridik, shoqëri tregtare apo korporatë, siç është përcaktuar me nenin 5 të kësaj rregullore, i cili diskualifikohet nga tenderimi në përputhje me nenin 10 të kësaj rregullore dhe rrjedhimisht i ndalohet Agjencisë të nënshkruaj kontratën e shitjes.
38. **“Pagesa”** nënkupton shumën e barabartë me totalin e çmimit të ofertës më të lartë MINUS depozita e ofertës.
39. **“Orari i tenderit”** nënkupton dokumentin ku caktohen afatet dhe datat e rëndësishme në lidhje me procesin e tenderit (i cili është i bashkëngjitur në Rregullat e Tenderit, si Shtojca A).
40. **“Pasuri”** nënkupton pasurinë, interesat apo pronën, ashtu siç është definuar me nenin 5 të Ligjit për Agjencinë, mbi të cilën Agjencia ushtron autoritetin e saj administrativ.
41. **“Periudha për dorëzimin e ofertës”** nënkupton datën dhe intervalin kohor, të caktuara nga Agjencia, sipas kohës së Kosovës, gjatë së cilës duhet të dorëzohen ofertat në Agjenci dhe/apo në vendin e caktuar nga Agjencia, hollësitë e të cilave paraqiten në njoftimin për tender.

42. **“Person”** nënkupton çdo person fizik, person juridik, shoqëri tregtare apo korporatë.
43. **“Personeli i Agjencisë”** nënkupton stafin profesional dhe teknik të Agjencisë ashtu siç është përcaktuar në Ligjin për Agjencinë.
44. **“Personi kontrollues”** nënkupton secilin person fizik ose juridik sipas urdhrave, udhëzimeve dhe kontrollit të cilit çdo person juridik ose subjekt vepron, pavarësisht nëse personi kontrollues ka pozitën e drejtorit ekzekutiv, kryeshefit ekzekutiv, drejtorit të financave, kryesuesit të bordit të drejtorëve, ndonjë aksionar i madh, apo ndonjë pozitë tjetër përmes së cilës mund të ushtrroj kontrollin mbi ndërmarrjen dhe stafin e saj.
45. **“Përfaqësuesi”** nënkupton secilin person i cili është i autorizuar ligjërisht për të vepruar në emër të ofertuesit gjatë tenderit, përfshirë këtu edhe nënshkrimin e Kontratës për Shitjen e Aksioneve dhe çfarëdo dokumenti tjetër që është relevant.
46. **“Rregullat e Tenderit”** nënkupton këto Rregulla të Përgjithshme të Tenderit.
47. **“Subjekti i ri”** nënkupton shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar e cila themelohet nga Agjencia sipas nenit 8 të Ligjit për Agjencinë (ku Agjencia vepron në emër të NSH-së) i cili subjekt do të përmbajë artikujt e tenderuar dhe e cila do të vihet në tender për privatizim.
48. **“Tarifa për dorëzimin e ofertës”** nënkupton tarifën e pakthyeshme, përveç rasteve të përcaktuara në këtë rregullore, për dorëzimin e ofertës në shumë prej 200 € (dyqind euro) që i paguhet Agjencisë nga ofertuesi në pajtim me nenin 7.1 të kësaj rregullore.
49. **“Tavolina kontrolluese”** nënkupton zyrtarët e Agjencisë të përcaktuar për evidentimin e dokumenteve të tenderit të dorëzuara në ditën e shitjes.
50. **“Tender”** nënkupton procesin e tërësishëm përmes të cilit Agjencia vë në privatizim subjektin e riapo vë në shitje asetin e tenderuar, bën klasifikimin dhe identifikimin e ofertës me çmimin më të lartë dhe përfundon shitjen e subjektit të ri apo asetit të tenderuar, ofertuesit fitues të përkohshëm.
51. **“Verifikimi i ofertuesit me çmimin më të lartë”** nënkupton verifikimin e informatave/dokumenteve të bëra nga Agjencia, që ka për qëllim konstatimin se ofertuesi me çmimin më të lartë nuk është ofertues me ndalesë sipas nenit 10 të kësaj rregullore.

52. **“Xhirollogaria e Caktuar”** nënkupton xhirollogarinë bankare të caktuar nga Agjencia për të pranuar çmimin blerës nga ofertuesi fitues i përkohshëm, hollësitë e të cilit do t’i sigurohen ofertuesit fitues të përkohshëm.

Neni 3

Vlefshmëria juridike dhe interpretimi i Rregullave të Tenderit

1. Rregullat e Tenderit janë të detyrueshme për zbatim si për Agjencinë ashtu edhe për çdo person i cili merr pjesë apo përfshihet në procedurat e privatizimit apo likuidimit, sipas Rregullave të Tenderit. Për t’u marrë parasysh një ofertë, duhet të jetë në pajtim me Rregullat e Tenderit. Me pjesëmarrjen e ofertuesit në çfarëdo faze të tenderimit ose me dorëzimin e ofertës, ofertuesi pajtohet dhe ndërmerr masa që t’iu nënshtrohet kushteve dhe procedurës së përcaktuar me Rregullat e Tenderit.
2. Rregullat e Tenderit interpretohen në frymën e Ligjit për Agjencinë dhe të Politikave Operacionale të cilat janë në fuqi. Në rast se ndonjë dispozitë e Rregullave të Tenderit është në kundërshtim me Ligjin për Agjencinë apo me Politikën Operacionale, do të zbatohet Ligji për Agjencinë, përkatësisht Politikën Operacionale.
3. Çdo gjë që i referohet gjinisë mashkullore i referohet edhe gjinisë femërore dhe çdo gjë që i referohet gjinisë asnjënjëse i referohet gjinisë mashkullore dhe asaj femërore.
4. Çdo gjë që i referohet njëjësit i referohet edhe shumësit dhe anasjelltas, përveç nëse nga konteksti i fjalisë nuk mund të interpretohet në atë mënyrë.
5. Titujt janë vënë vetëm për të lehtësuar kuptimin e Rregullave të Tenderit, ashtu që nuk ndikojnë në strukturën apo interpretimin e tyre.

Neni 4

Aspekte të përgjithshme mbi procesin e shitjes

1. **Pasqyrë e përgjithshme e rolit të Agjencisë:** Agjencia Kosovare e Privatizimit (“Agjencia”) është institucion i pavarur publik i Republikës së Kosovës, e cila ushtron funksionet dhe përgjegjësitë e saj me autonomi të plotë, në përputhje me Ligjin për Agjencinë, me Politikën Operacionale të Agjencisë, me këto Rregulla të Tenderit dhe me aktet e tjera ligjore e nënligjore që janë në fuqi në Republikën e Kosovës. Agjencia ka në mandatin e saj që të administroj me ndërmarrjet dhe asetet siç është përcaktuar me Ligjin për Agjencinë, duke përfshirë edhe autoritetin për shitjen, transferimin dhe/ose likuidimin e tyre. Agjencia ka zotësi të plotë juridike

dhe rrjedhimisht mund të jetë palë paditëse apo e paditur, në procedurën gjyqësore apo në ndonjë procedurë të ngjashme.

2. Struktura e shitjes dhe pasqyra e ofertës: Agjencia në emër të NSH-së do të themelojë subjektin e ri dhe Agjencia do të mbaj në mirëbesim për NSH-në, kapitalin e subjektit të ri të nxjerrë në aksione. Si pjesë integrale e tenderit, Agjencia do të kryej shitjen e kapitalit të subjektit të ri të nxjerrë në aksione, në emër të NSH-së dhe artikujt e tenderuar do të transferohen tek subjekti i ri për një kohë të caktuar.

2.1. Subjekti i ri dhe asetit i tenderuar do të tenderohet për shitje në tender publik në pajtim me procedurat e përcaktuara në Rregulla e Tenderit. Gjatë tenderit do të jetë një raund i ofertimit dhe këto rregulla të tenderit përcaktojnë procedurat që qeverisin tenderin, informatat dhe dokumentet që duhet të përfshihen në ofertë, identifikimin e çmimit të ofertës më të lartë dhe mënyrën se si të vazhdohet shitjae subjektit të ri dhe asetit të tenderuar, ofertuesit fitues të përkohshëm.

2.2. Për t'u marrë parasysh një ofertë, ofertuesi duhet të jetë në pajtim me Rregullat e Tenderit. Me pjesëmarrjen e ofertuesit në çfarëdo faze të tenderit ose me dorëzimin e ofertës, ofertuesi pajtohet dhe ndërmerr masa që t'i nënshtrohet kushteve të këtyre rregullave për tender.

2.3. Me dorëzimin e ofertës, ofertuesi duhet të përcaktoj se për cilin subjekt të ri apo aset të tenderuar është duke konkurruar dhe duhet të jap çmimin e ofertës.

3. Shitja bëhet sipas ofertës me çmimin më të lartë: Agjencia do të shes subjektin e ri apo asetin e tenderuar vetëm me çmimin e ofertës më të lartë. Ofertuesi më i lartë do të ketë të drejtë që të blejë asetin e tenderuar, vetëm me çmimin e ofertës më të lartë. Nëse për çfarëdo arsye, shitja nuk vazhdohet me ofertuesin më të lartë, atëherë ofertuesi i dytë më i lartë duke iu nënshtuar këtyre rregullave të tenderit do të ketë mundësinë, por nuk është i detyruar, të blejë subjektin e ri apo asetin e tenderuar me çmimin e ofertës më të lartë. Nëse për çfarëdo arsye, shitja nuk vazhdohet me ofertuesin e dytë më të lartë atëherë ofertuesi i tretë më i lartë duke iu nënshtuar këtyre rregullave të tenderit do të ketë mundësinë, por nuk është i detyruar, të blejë subjektin e ri apo asetin e tenderuar me çmimin e ofertës më të lartë.

4. Orari i tenderit: Agjencia do të përgatis orarin e tenderit (i cili është i bashkëngjitur në Rregullat e Tenderit, si Shtojca A). Ofertuesit duhet të konsultojnë orarin e tenderit, të informohen lidhur me afatet dhe datat e përcaktuara me të dhe t'iu përmbahen atyre gjatë procesit të tenderimit.

Neni 5 Ofertuesit me ndalesë ofertimi

1. Për qëllime të këtij tenderi, ofertuesit në vijim do të kenë ndalesë:
 - 1.1. Ndërmarrjet publike dhe shoqërore;
 - 1.2. Qeveria dhe institucionet qeveritare të Republikës së Kosovës, agjencitë dhe institucionet publike të pavarura;
 - 1.3. Qeveria, institucionet qeveritare, agjencitë dhe institucionet e tjera publike të cilido shtet apo vend tjetër;
 - 1.4. Personat fizik, personat juridik apo shoqëritë tregtare si dhe personat kontrollues dhe udhëheqës të personave juridik apo shoqërive tregtare të cilët janë të dënuar me burgim në kohëzgjatje një vit e më tepër për vepra penale kundër ekonomisë, rendit kushtetues, vepra që lidhen me krim të organizuar dhe të gjitha ato vepra penale që ngërthejnë në vete elemente të mashtrimit, të parapara me Kodin Penal. Palët të cilat e kanë vuajtur dënimin nuk janë ofertues me ndalesë;
 - 1.5. Personat fizik apo juridik të cilët kanë uzurpuar paluajtshmërinë në pronësi shoqërore ndaj të cilëve Agjencia apo NSH-ja ka iniciuar procedurë gjyqësore për lirim të pronës dhe/apokompensimin e dëmeve eventuale, me përjashtim të palëve që kanë nënshkruar kontratë të qirasë me Agjencinë apo palëve që nuk kanë kontratë të qirasë, por që këto palë e kanë paguar kompensimin e të gjitha detyrimeve për shfrytëzimin e pronës së NSH-së;
 - 1.6. Personat fizik dhe juridik që: (i) nuk i kanë respektuar kushtet e ndonjë kontrate të lidhur me Agjencinë ose me çfarëdo ndërmarrje që administrohet nga Agjencia (ekzistenca dhe natyra e atij mosrespektimi do të përcaktohet nga Agjencia sipas zgjedhjes së saj), (ii) kanë borxh ose gjobë të pashlyer ndaj Agjencisë ose ndonjë ndërmarrje që administrohet nga Agjencia, (iii) të cilët nuk kanë paguar gjobat e caktuara nga Agjencia ose që i nënshtrohen ndonjë kërkesëpadie ose kontesti (pa marrë parasysh nëse çështja e tillë është ngritur në gjykatë apo tjetërkund). Përjashtimisht, palët të cilat e paguajnë borxhin ndaj Agjencisë ose NSH-ve para nënshkrimit të kontratës së shitblerjes nuk konsiderohen ofertues me ndalesë;
 - 1.6.1. personat fizik dhe juridik të cilët sipas mendimit të arsyeshëm dhe të argumentuar të Agjencisë: janë përfshirë në ndonjë marrëveshje të fshehtë apo në ndonjë aktivitet tjetër jo ligjor apo të pa rregullt, dhe si rrjedhojë Agjencia ka anuluar ndonjë tender të likuidimit;

- 1.6.2. në ndonjë mënyrë tjetër kanë shkelur rregullat e tenderit për çfarëdo tenderi të privatizimit apo likuidimit, të organizuar nga Agjencia; ose
 - 1.6.3. janë tërhequr nga pozita e tyre si ofertues fitues i përkohshëm në ndonjë tender të likuidimit dy (2) herë pas dështimit për të depozituar shumën e çmimit të ofertës së tyre fituese brenda periudhës së kërkuar nga Agjencia pas shitjes SHAL 55 ose përmes refuzimit të tyre për të nënshkruar dokumentet e shitjes gjatë çfarëdo tenderi të privatizimit të organizuar nga Agjencia;
 - 1.7. Subjektet juridike, ku pronarët përfitues ose personat kontrollues të tyre i takojnë kategorive të theksuara në këtë nen;
 - 1.8. Subjektet juridike ku pronarët, personat përfitues apo personat kontrollues të tyre kanë qenë apo janë pronarë, persona përfitues apo persona kontrollues të ndonjë subjekti tjetër juridik, i cili i takon ndonjërisht nga kategoritë e theksuara në këtë nen.
2. Çfarëdo oferte e dorëzuar nga një ofertues me ndalesë do të diskualifikohet, pavarësisht nga fakti nëse oferta e tillë është në pajtim të plotë me kushtet dhe afatet e përcaktuara me Rregullat e Tenderit.

Neni 6

Hulumtimi paraprak dhe marrja e dokumenteve të tenderit

1. Është në përgjegjësinë e secilit ofertues të mundshëm që të bëjë hulumtimin paraprak në lidhje me NSH-në, subjektin e ri apo asetin e tenderuar, me qëllim të mbledhjes së informatave të nevojshme.
2. Në njoftimin për tender, ofertuesit e mundshëm udhëzohen që brenda afatit të caktuar të kontaktojnë zyrën e caktuar në Agjenci për marrjen e dokumenteve përkatëse të tenderit, përfshirë dosjen elektronike. Ofertuesit e mundshëm mund të qasen në dosjen elektronike vetëm në ditët dhe kohën e specifikuar në orarin e tenderit, ndërsa për ofertuesit fitues të përkohshëm në çdo kohë deri në finalizim të tenderit. Dokumentet e tenderit dhe dosja elektronike mund të merret me anë të kërkesës me postë elektronike në adresën sales@paks.org apo në ndonjërin nga adresat zyrtare të AKP-së, si dhe zyrën qendrore të AKP-së.
3. Ofertuesi i mundshëm duhet të nënshkruajë deklaratën për ruajtjen e sekretit afarist e cila është e përfshirë në dokumentet e tenderit dhe ta kthejë atë në Agjenci para se ofertuesit t'i lejohet të ketë qasje në informata dhe dokumentacion në dosjen elektronike apo të vizitojë

vendndodhjen dhe hapësirat e NSH-së, subjektit të ri apo asetit të tenderuar për qëllime të kryerjes së hulumtimit të tyre paraprak.

4. Duke vepruar sipas kërkesave të ofertuesve të mundshëm, Agjencia para dorëzimit të ofertave do t'iu mundësoj atyre që të vizitojnë vendndodhjen dhe hapësirat e NSH-së, asetit të tenderuar sipas publikimit në shpalljet e tenderit. Ofertuesit e mundshëm duhet të paraqesin kërkesat e tyre dhe të caktojnë takimet apo vizitat vetëm përmes Agjencisë.
5. Me dorëzimin e ofertës, ofertuesi duhet të pohoj dhe të konfirmoj para Agjencisë me shkrim, se i është dhënë mundësia dhe i janë ofruar kushtet nga ana e Agjencisë për të bërë hulumtime paraprake dhe vlerësime të pavarura lidhur me NSH-në, asetin e tenderuar dhe të gjitha informatat dhe dokumentet që gjenden në dosjen elektronike.
6. Moskryerja e hulumtimeve paraprake dhe vlerësimeve të pavarura në lidhje me NSH-në, subjektin e ri apo asetin e tenderuar, si dhe në lidhje me çfarëdo dhe të gjitha informatat dhe dokumentet që gjenden në dosjen elektronike, nuk e liron ofertuesin e mundshëm nga kryerja e obligimeve të tij sipas kontratës së shitjes dhe dokumenteve të tjera përkatëse. As Agjencia e as NSH-ja nuk marrin përgjegjësi për vlerësimet dhe përfundimet e nxjerra nga cilido ofertues, pas hulumtimit paraprak dhe hetimeve të pavarura të ofertuesit të tillë, pas vlerësimit nga ana e tij, të NSH-së, subjektit të ri apo asetit të tenderuar, si dhe pas hulumtimeve dhe vlerësimit të informatave dhe dokumentacionit, të paraqitura në dosjen elektronike.
7. Çdo ofertë e cila varet nga hulumtimet e mëtejshme, hulumtimet tjera apo nga oferta e një ofertuesi tjetër do të konsiderohet si jo e plotë dhe e papranueshme nga ana e Agjencisë.
8. Si rezultat i rrethanave deri në qershor të vitit 1999 në Kosovë, është e njohur dhe konfirmuar nga të gjitha palët përkatëse se një pjesë e informatave dhe dokumentacionit në lidhje me NSH-në, asetin e tenderuar mund të kenë humbur, të jenë shkatërruar ose hequr nga vendndodhja dhe hapësirat e NSH-së dhe mund të konsiderohet se nuk janë në dispozicion. Për këtë arsye, ofertuesve të mundshëm iu tërhiqet vëmendja se çfarëdo analize e informatave ose dokumenteve mund të jetë jo e plotë dhe duhet të shoqërohet nga një vlerësim i thellë i NSH-së, subjektit të ri apo asetit të tenderuar. As Agjencia e as NSH-ja nuk marrin përgjegjësi ose obligim në lidhje me çfarëdo mungese në informatat dhe dokumentet që janë në dispozicion në lidhje me NSH-në, subjektin e ri apo asetin e tenderuar.
9. Nga Agjencia nuk kërkohet të përkthej çfarëdo informate ose dokumenti në lidhje me NSH-në, subjektin e ri apo asetin e tenderuar. Ofertuesi i mundshëm është përgjegjës për çdo interpretim ose përkthim të informatave dhe dokumenteve gjatë procesit të hulumtimit paraprak. Personat të cilët ofertuesit të mundshëm i ofrojnë çfarëdo shërbime duhet t'iu

përshtaten obligimeve për ruajtjen e sekretit afarist të përcaktuara në këto rregulla tenderi dhe Agjencia kërkon që ata persona të nënshkruajnë deklaratën për ruajtjen e sekretit afarist.

Neni 7

Tarifa për dorëzimin e ofertës dhe depozita e ofertës

1. Për kompensimin e kostove administrative dhe të komunikimit të cilat janë të lidhura me shqyrtimin dhe përpunimin e ofertave nga ana e Agjencisë, secili ofertues duhet të paguaj tarifën për dorëzimin e ofertës, në shumën prej 200 € (dyqind euro). Ofertuesisë bashku me ofertën e tij duhet të dorëzoj edhe dëshminë e pagesës së tarifës. Tarifa për dorëzimin e ofertës paguhet me anë të një transferi bankar në xhirollogarinë bankare të caktuar nga Agjencia për atë qëllim dhe vlen vetëm për një njësi/aset të caktuar.
2. Për të siguruar vullnetin e mirë të ofertuesve, secili ofertues duhet që të paguaj depozitën e ofertës, lartësia e së cilës caktohet nga Agjencia, në baza individuale për secilin subjekt të ri apo aset të tenderuar. Depozita e ofertës paguhet me anë të një transferi bankar në xhirollogarinë bankare të caktuar nga Agjencia për atë qëllim. Ofertuesi së bashku me ofertën duhet të dorëzojë në Agjenci edhe dëshminë e pagesës së depozitës së ofertës. Agjencia e krediton depozitën e ofertës së paguar nga ofertuesi fitues i përkohshëm ndaj shumës së përgjithshme të çmimit të ofertës më të lartë, që i paguhet Agjencisë për përfundimin e blerjes së subjektit të ri apo asetit të tenderuar.
3. Ofertuesve jo fitues Agjencia do t'ua kthej depozitën e ofertës brenda 10 (dhjetë) ditë pune pas përfundimit të periudhës për dorëzimin e ofertës.
4. Në rast se Agjencia ia konfiskon ofertuesit depozitën e ofertës për shkaqet e përcaktuara me Rregulla të Tenderit atëherë nuk do t'ia kthej atë ofertuesit.
5. Tarifa administrative iu kthehet ofertuesve në rastet kur ofertuesi nuk ka dorëzuar ofertë.
6. Depozita e ofertës dhe tarifa administrative iu kthehet ofertuesve në rastet kur Agjencia e tërheq një aset nga procesi i tenderimit para dorëzimit të ofertave.

Neni 8

Përmbajtja dhe dorëzimi i ofertave

1. Gjatë tenderit do të ekzistoj vetëm një raund i ofertimit.

2. Të drejtën për të paraqitur ofertë e gëzon çdo person fizik apo juridik. Për një aset mund të dorëzohet vetëm një ofertë nga i njëjti ofertues. Personi i cili dorëzon ofertën nuk duhet të identifikoj ofertuesin në emër të të cilit dorëzon ofertën.
3. Ofertat duhet të dorëzohen në njërën nga gjuhët zyrtare të Kosovës (gjuhë shqipe apo serbe), ose në gjuhën angleze.
4. Ofertat duhet të dorëzohen të mbyllura në vendin e caktuar nga Agjencia përmes njoftimit për tender. Zarfët e mbyllur të përmendur në paragrafin 7.1 dhe 7.2 të këtij neni, duhet të vendosen së bashku në një zarf të tretë të mbyllur me mbishkrimin “**Oferta për tenderin nr. [●]**”. Në anën e jashtme të atij zarfi nuk duhet të jepet asnjë informatë apo shenjë tjetër që mund të identifikojnë ofertuesin. Të gjitha ofertat do të dorëzohen në zarf të bardhë.
5. Të gjitha ofertat duhet të dorëzohen në vendin e caktuar nga Agjencia përmes njoftimit për tender. Ofertat duhet të dorëzohen në mënyrë fizike pranë komisionit të Agjencisë për pranimin e ofertave.
6. Ofertat duhet t’i dorëzohen komisionit për pranimin e ofertave gjatë periudhës për dorëzimin e ofertave në pajtim me këtë rregullore. Komisioni për pranimin e ofertave nuk do të pranoj ofertat të cilat paraqiten pas përfundimit të periudhës për dorëzimin e ofertave ose që paraqiten në ndonjë vend tjetër përveç siç është përcaktuar në nenin 8.5 të kësaj rregullore.
7. Ofertës duhet t’i bashkëngjiten dëshmitë dhe dokumentet në mënyrën si në vijim:
 - 7.1. Informatat dhe dokumentet në vijim duhet të futen në një zarf të mbyllur me fjalët “Informatat për ofertën” të shtypura në pjesën e jashtme të zarfit:
 - 7.1.1. Kopjen e një dokumenti identifikues (p.sh. letërnjoftimit ose pasaportës) të ofertuesitose personit që është nënshkruar i ofertës sipas autorizimit nga ofertuesi;
 - 7.1.2. Dëshmi e cila tregon që tarifa për dorëzimin e ofertës është transferuar në xhirollogarinë e caktuar nga Agjencia për atë qëllim;
 - 7.1.3. Dëshmi e cila tregon që depozita e ofertës është transferuar në xhirollogarinë e caktuar nga Agjencia për atë qëllim.
 - 7.1.4. Dëshmia e pagesës për tarifë administrative dhe depozitë të ofertës mund të bëhet me anë të kopjes së transferit elektronik bankar.
 - 7.2. Çmimi i ofertës duhet të vendoset në një zarf të veçantë me fjalët “Çmimi i Ofertës” të shtypura në pjesën e jashtme. Në Shtojcën B të këtyre rregullave të tenderit është dhënë

forma ku duhet të shkruhet shuma e përgjithshme e parave që duhet t'i paguhet Agjencisë nga ofertuesi nëse ky çmim i ofertës së ofertuesit konsiderohet të jetë çmimi i ofertës më të lartë. Ofertuesit duhet të plotësojnë këtë formë dhe ta dorëzojnë atë me anë të zarfit të mbyllur me mbishkrimin "Çmimi i Ofertës".

8. Komisioni për pranimin e ofertave, menjëherë pas pranimit të ofertës, do të shkruaj një numër mbi zarfin e tretë të mbyllur, të përmendur në paragrafin 6 të këtij neni dhe të njëjtin numër do ta regjistroj në dëftesën e cila lëshohet në pajtim me paragrafin 9 të këtij neni.
9. Komisioni për pranimin e ofertave menjëherë pas regjistrimit të numrit në dëftesë do t'ia dorëzojë dëftesën personit i cili e ka dorëzuar ofertën në të cilën theksohet data, ora dhe minuta e pranimit të ofertës nga Agjencia. Në momentin e dorëzimit të ofertës, secilit ofertues i përcaktohet një shifër identifikuese. Dëftesa duhet të jetë e nënshkruar nga komisioni për pranimin e ofertave dhe ofertuesi (vetëm me nënshkrim e jo me emër).
10. Ofertuesit janë të detyruar që t'i sigurojnë Agjencisë të gjitha informatat dhe dokumentet e kërkuara nga Agjencia në pajtim me këtë rregullore me qëllim të mbarëvajtjes së procesit të privatizimit dhe plotësimit të kushteve të rregullave të tenderit.
11. Gjatë ditës së shitjes apo ceremonisë së hapjes së ofertave, Komisioni Verifikues do të shqyrtojë vetëm ofertat të cilat kanë hasur në parregullsi apo probleme nga tavolina kontrolluese, para se ato të dërgohen tek Komisioni për hapjen e ofertave. Nëse ndonjëra nga dokumentet e cekura në paragrafin 7.1.2 dhe 7.1.3 të këtij neni nuk janë dorëzuar apo numri i llogarive bankare nuk korrespondon me llogaritë e cekura në njoftimin për tender, Komisioni do të refuzoj ofertuesin, dhe oferta e tij, siç është përcaktuar në nenin 7.2 të këtyre Rregullave të Tenderit, nuk do të hapet. Nëse dokumenti i cekur në paragrafin 7.1.1 të këtij neni nuk është dorëzuar, mungesa e tij evidentohet në procesverbal të Komisionit Verifikues të ofertave dhe do të kërkohet së bashku me dokumentet tjera të cekura në Neni 11 – Shpallja e fituesit të përkohshëm dhe pagesa e çmimit të blerjes.

Neni 9

Hapja e ofertave

1. Ofertat do të hapen nga komisioni për hapjen e ofertave, në mënyrë publike, menjëherë pas përfundimit të periudhës për dorëzimin e ofertës. Procesi i hapjes së ofertave vazhdon derisa të hapet oferta e fundit.
2. Komisioni për hapjen e ofertave do të bëjë identifikimin dhe shpalljen publike të çmimeve të të gjitha ofertave të dorëzuara për blerjen e subjektit të ri apo asetit të tenderuar.

3. Komisioni i regjistrimit të ofertave do të bëjë inkorporimin e ofertave të pranuar në ditën e shitjes apo ceremoninë e hapjes së ofertave, në formë tabelare, publikisht.

Neni 10

Procedurat e verifikimit

1. Agjencia në çdo kohë duke përfshirë edhe fazën e përmbylljes së kontratës së shitjes së subjektit të ri apo asetit të tenderuar, mund të kërkoj nga ofertuesi dorëzimin e informatave apo dëshmime shtesë në pajtim me këtë rregullore, të cilat i vlerëson si relevante për statusin e ofertuesit me çmimin më të lartë.
2. Komisioni Vlerësues i ofertave do të shqyrtoj dokumentet dhe dëshmitë pas ditës së shitjes vetëm për ofertuesit me çmimin më të lartë dhe për rastet tjera të mundshme të cilat kanë hasur në parregullsi gjatë çfarëdo faze të procesit të tenderimit.
3. Komisioni Vlerësues do të pranojë nga departamentet relevante të Agjencisë të dhënat mbi ofertuesit dhe në bazë të tyre do të gjeneroj një listë ku përfshihen të gjithë ofertuesit me ndalesë. Kjo listë hartohet dhe do të përditësohet nga Komisioni Vlerësues.
 - 3.1. Komisioni vlerësues do të konstatoj nëse ofertuesi me çmimin më të lartë bie në kategorinë e ofertuesve me ndalesë (siç është përcaktuar me nenin 5 të kësaj rregullore) dhe se i plotëson kushtet dhe kriteret e përcaktuara me këtë rregullore. Nëse brenda një vale të shitjes, një ofertues ka aplikuar për më shumë se një aset dhe i njëjti është shpallur ofertues me çmimin më të lartë për më shumë se një aset, konstatimi si ofertues me ndalesë vlen për të gjitha rastet.
 - 3.2. Komisioni vlerësues do të konstatoj se ofertuesi me çmimin më të lartë bie në kategorinë e ofertuesve me ndalesë (siç janë përcaktuar me nenin 5 të kësaj rregullore) edhe në rastin kur ofertuesi nuk ka dorëzuar dëshmitë gjegjëse edhe përkundër kërkesës nga ana e personelit të Agjencisë për kompletimin e lëndës.
 - 3.3. Komisioni vlerësues do të bëjë shqyrtimin e këtyre dokumenteve do të konstatoj nëse ofertuesit me ofertën më të lartë janë ofertues me ndalesë para dorëzimit për aprovimin përfundimtar nga Bordi i Drejtorëve;
4. Agjencia dot'i trajtoj si konfidenciale të gjitha informatat e ofruara nga ofertuesi dhe se nuk do t'ia zbuloj ato palëve të treta, përveç nëse: (a) kërkohet nga ligji i zbatueshëm ose nga ndonjë urdhëresë e lëshuar nga ndonjë gjykatë e juridiksionit kompetent ose (b) kërkohet nga agjencitë për zbatimin e ligjit në Kosovë dhe jashtë saj ose (c) kërkohet nga çfarëdo organi i

autorizuar me ligj, për hetimin e të kaluarës së ofertuesit ose (d) nëse ofertuesi është pajtuar ndryshe me shkrim.

5. Kundër vendimit për konstatimin si ofertues me ndalesë mund të parashtrohet ankesë te Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë në afatin prej pesë ditësh nga dita e pranimi të vendimit. Komisioni i shkallës së dytë në përbërje të tre (3) anëtarëve të nivelit të udhëheqësve të divizioneve do t'i rekomandoj Drejtorit Ekzekutiv brenda tre (3) ditëve lidhur me vendimin për ankesën. Vendimi i Drejtorit Ekzekutiv mund të kundërshtohet në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme.

Neni 11

Shpallja e fituesit të përkohshëm dhe pagesa e çmimit të blerjes

1. Duke iu nënshtruar kushteve të përcaktuara në këtë rregullore, aseti i tenderuar i shitet ofertuesit më të lartë sipas kushteve në vijim:
 - 1.1. Agjencia brenda **3 (tre) ditë pune** nga periudha për dorëzimin e ofertës njofton ofertuesin me çmimin më të lartë të ofruar, se oferta e tij është ranguar si më e larta.
 - 1.2. Ofertuesi me çmimin më të lartë (personat fizik, përfaqësuesit apo pronarët e personave juridik, apo konsorciumet) duhet të dorëzojnë dokumentet në vijim, brenda afatit të cekur në njoftimin e Agjencisë:
 - 1.2.1. certifikatën nga gjykata kompetente se nuk është person i dënuar. Kjo certifikatë nuk duhet të jetë e datës para ditës së ofertimit dhe do të trajtohet në përputhje me nenin 5 dhe nenin 10 të kësaj rregullore.
 - 1.2.2. informatat e mëposhtme në lidhje me ofertuesin e mundshëm:
 - 1.2.2.1. nëse ofertuesi është më shumë se një person fizik, duhet të dorëzohet një kopje e dokumentit të noterizuar që dëshmon organizimin e personave fizik për të marrë pjesë në tenderim si një ofertues, së bashku me kopjet e letërnjoftimeve dhe identitetin e personave fizik pjesëmarrës në këtë organizim;
 - 1.2.2.2. nëse ofertuesi është subjekt juridik duhet të dorëzohet një kopje të certifikatës së regjistrimit të aktivitetit të tij afarist, së bashku me kopjet e letërnjoftimeve dhe identitetin e pronarëve përfitues dhe personave kontrollues. Vërtetimi i identitetit të pronarëve përfitues dhe personave kontrollues nuk kërkohet nga subjektet juridike të cilat gjenden në listat

e bursave ndërkombëtarisht të njohura, duke pasur parasysh që listat e tilla janë në dispozicion; dhe

1.2.2.3. në rast se ofertuesi është konzorcium i përbërë prej personave fizik, ortakërive dhe kompanive, duhet të dorëzohen kopjet e dokumenteve themeluese të atij konzorciumi, së bashku me kopjet e letërnjoftimeve, pasaportave dhe të dhënat e regjistrimit të biznesit të pjesëmarrësve në konzorcium, përfshirë këtu edhe të dhënat mbi identitetin e pronarëve përfitues dhe personave kontrollues të anëtarëve të konzorciumit;

2. Njoftimi për vendimin mbi shpalljen e fituesit të përkohshëm apo anulimin e shitjes kumtohet pasi që Bordi të miratoj apo refuzoj shitjen dhe se depozita nuk kthehet deri në marrjen e këtij vendimi. Në bazë të vendimit të Bordit, Agjencia njofton se:
 - 2.1. Nëse shitja aprovohet, i njëjti është ofertues fitues i përkohshëm dhe se do të paguaj shumën e çmimit të ofertuar në xhirollogarinë e caktuar, apo
 - 2.2. Nëse shitja refuzohet, ofertuesit me çmimin më të lartë të ofruar do t'i kthehet depozita e ofertës në pajtim me paragrafin 3, të nenit 7 të kësaj rregullore.
3. Pas aprovimit të çmimit të shitjes nga bordi i drejtorëve, Agjencia do të ftoj ofertuesin të paguaj çmimin e ofertës më të lartë, në xhirollogarinë e caktuar, sipas kushteve në vijim:
 - 3.1. Nëse çmimi i ofertës më të lartë është deri në 499,999 € (katërqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë euro), brenda 45 (katërdhjetë e pesë) ditë pune nga data e njoftimit;
 - 3.2. Nëse çmimi i ofertës më të lartë është prej 500,000 € (pesëqind mijë euro) deri në 999,999 €, brenda 50 (pesëdhjetë) ditë pune nga data e njoftimit;
 - 3.3. Nëse çmimi i ofertës më të lartë është 1,000,000€ (një milion euro) apo më i lartë, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditë pune nga data e njoftimit.
4. Fituesit të përkohshëm do t'i merret e drejta për kryerjen e blerjes së subjektit të ri apo asetit të tenderuar dhe do t'i konfiskohet depozita e ofertës nga Agjencia për shkak se ka dështuar në pagesën në xhirollogarinë e caktuar brenda afatit të paraparë në paragrafin 3 të këtij neni.
5. Përjashtimisht, ofertuesit do t'i kthehet depozita e ofertës për shkak të ushtrimit të kanosjes, shtrëngimit apo të ndonjë akti të ngjashëm kriminal, të drejtuar kundër jetës, integritetit personal apo pasurisë së tij, apo të drejtuar kundër ndonjë familjari të tij, me qëllimin që

ofertuesi të tërhiqet nga oferta, vetëm nëse ngrihet aktakuza kundër personit të dyshuar për kryerjen e aktit apo akteve të tilla kriminale, nga organet kompetente.

6. Mjetet që shfrytëzohen nga ofertuesi fitues i përkohshëm për të kryer pagesën e çmimit të ofertës më të lartë nuk paguhen në para të gatshme dhe nuk duhet të kenë origjinën nga ndonjë juridiksion që është në listën e zezë të FATF (ang“*Financial Action Task Force*” – Task Forca e Veprimit Financiar) nga organet tjera kompetente.
7. Në rast se Agjencia e diskualifikon ofertuesin fitues të përkohshëm (siç është përcaktuar ne Rregulla të Tenderit), Agjencia do të kontaktoj ofertuesin e dytë më të lartë duke e ftuar që të blejë asetit e tenderuar me çmimin e ofertës më të lartë të ofertuesit të parë.
8. Ofertuesi i dytë më i lartë brenda afatit prej 3 (tre) ditë pune pas pranimit të shkresës nga Agjencia:
 - 8.1. e njofton Agjencinë me shkrim nëse dëshiron të vazhdojë me blerjen e subjektit të ri apo asetit të tenderuar me çmimin e ofertës më të lartë; dhe
 - 8.2. transferon depozitën e ofertës në xhirollogarinë bankare të caktuar nga Agjencia për atë qëllim, në rast se depozita e ofertës i është kthyer ofertuesit të dytë më të lartë në pajtim me këtë rregullore.
9. Nëse ofertuesi i dytë më i lartë nuk vepron sipas paragrafit 8.1 dhe 8.2 të këtij neni, atëherë Agjencia do të ketë të drejtën që mos përgjigjen e tij ta trajtojë si refuzim të ftesës së Agjencisë për blerjen e subjektit të ri apo asetit të tenderuar.
10. Nëse ofertuesi i dytë më i lartë nuk dëshiron të bëjë blerjen e subjektit të ri apo asetit të tenderuar me çmimin e ofertës më të lartë, atëherë Agjencia do të vazhdoj procesin duke e ftuar ofertuesin e tretë më të lartë që të blejë subjektin e ri apo asetin e tenderuar me çmimin e ofertues më të lartë.
11. Rregullat e Tenderit të cilat zbatohen për ofertuesin me të lartë do të zbatohen edhe për ofertuesin e dytë më të lartë, dhe po ashtu Rregullat e Tenderit të cilat zbatohen për ofertuesin e parë dhe të dytë më të lartë, do të zbatohen në mënyrë identike edhe kur kemi të bëjmë me ofertuesin e tretë më të lartë.
12. Duke mos u kufizuar në kuptimin e përgjithshëm të nenit 11 të kësaj rregullore dhe pa pasur paragjykime për çfarëdo shkak të vonesës apo anulimit të tenderit të përcaktuar me këtë rregullore, në rast se shitja e subjektit të ri apo asetit të tenderuar me ofertuesin më të lartë,

ofertuesin e dytë më të lartë ose ofertuesin e tretë më të lartë nuk është e mundur sipas kësaj rregullore, atëherë Agjencia do të anulojë tenderin.

Neni 12

Klasifikimi i ofertave me çmime të njëjta

Në rast se ekzistojnë dy ose më shumë oferta të dorëzuara nga ofertuesit të cilët kanë çmime të njëjta, atëherë prioritet do të ketë oferta e cila është dorëzuar dhe regjistruar më herët për nga koha.

Neni 13

Modifikimi dhe tërheqja e ofertave

1. Nuk lejohet asnjë ndryshim/përmirësim i çmimit të ofertës.
2. Agjencia do të shpallë të pavlefshme ofertën e dorëzuar e cila ka ndryshim/përmirësim të çmimit të ofertës së dorëzuar.
3. Pas dorëzimit të ofertës në vendin e caktuar sipas shpalljes në tenderin publik, ofertuesi nuk mund të tërheqë ofertën e tij. Në rast se ofertuesi e tërheqë ofertën e tij pas dorëzimit të saj, do t'i konfiskohet depozita e ofertës, përveç rasteve kur ofertuesi e tërheqë ofertën mbi bazën e nenit 11.5 të kësaj rregullore.

Neni 14

Aprovimi dhe refuzimi i ofertave për asetet/subjektet e reja të tenderuara

1. Bordi aprovon shitjet, bazuar në informatat relevante të prezantuara sipas metodologjisë për përcaktimin e çmimeve orientuese, nëse çmimi i ofertës më të lartë të artikujve të tenderuar ka lidhje racionale me vlerën orientuese sipas Shtojcës së Procedurave të Shitjes, rrjedhimisht ekzistojnë arsyet ekonomike që të aprovohet oferta.
2. Përgjashtimisht nga neni 14.1, Bordi mban të drejtën të vendos për aprovimin e ofertës më të lartë të pranuar në tenderin publik për atë aset, sipas diskrecionit në pajtim me mandatin e tij i cili buron nga Ligji për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 pa marr parasysh vlerën orientuese sipas Shtojcës së Procedurave të Shitjes, sikurse në vijim:
 - 2.1 Asetet që janë tenderuar 3 (tri) e më shumë herë, respektivisht ky nen aplikohet nga hera e katërt e tenderimit;

- 2.2 Asetet të cilat janë asetet e fundit të ndërmarrjeve, respektivisht 1 apo 2 asetet e fundit të ndërmarrjes.
3. Bordi refuzon ofertat e pranuar në rastet si në vijim:
- 3.1 Nëse sipas vlerësimit të Bordit, bazuar në informatat relevante të prezantuara sipas metodologjisë për përcaktimin e çmimeve orientuese, çmimi i ofertës më të lartë për asetet e tenderuar nuk ka lidhje racionale me vlerën orientuese sipas Shtojcës së Procedurave të Shitjes;
- 3.2 Nëse Agjencia pranon indikacione të bazuara apo dyshime të bazuara për ndonjë marrëveshje të fshehtë në mes të ofertuesve, apo në ndonjë aktivitet tjetër ilegal apo të parregullt të shkaktuar në lidhje me procesin e tenderimit. Në rastet e refuzimit të ofertave, depozitat kthehen sipas procedurave të parapara me këtë rregullore.
4. Në raste kur paraqiten informata të reja, për të cilat kërkohet një analizë apo qartësim shtesë përkitazi me ato informata, Bordi mund të zgjedh shtyrjen e vendimmarrjes për atë aset më së largu deri në mbledhjen e radhës të Bordit.
5. Për secilin aprovim apo refuzim të ofertës menaxhmenti do të ofroj informata dhe rekomandim për Bordin duke u bazuar në metodologjinë për përcaktimin e çmimeve orientueses sipas Shtojcës së Procedurave të Shitjes.
6. Në rastet kur tenderi anulohet, për arsye të cilat e bëjnë të pamundur aprovimin apo refuzimin e ofertës sipas nenit 14.1 dhe 14.3 të kësaj rregullore, Agjencia njofton me shkrim ofertuesin me çmimin më të lartë për anulimin e tillë. Në këtë rast:
- 6.1 të gjitha depozitat e ofertave të pranuar dhe tarifat administrative do të kthehen nga Agjencia brenda afatit prej 10 (dhjetë) ditë pune nga dita e anulimit të tenderit.
- 6.2 përjashtimisht tarifa administrative do të kthehet edhe në raste tjera përveç më lartë me vendim të Bordit, nëse anulimi i tenderit është bërë pa fajin e ofertuesve.
7. Agjencia nuk mbahet përgjegjëse për çfarëdo kosto ose detyrime që i janë shfaqur cilido ofertues ose çfarëdo pale të tretë.

Neni 15 **Kontrata e shitjes**

1. Agjencia dhe ofertuesi fitues i përkohshëm do të bëjnë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të nënshkruar kontratën e shitjes brenda afatit prej 20 (njëzet) ditë pune, nga data e pagesës së plotë të çmimit të shitjes.
2. Agjencia sipas zgjedhjes së saj duke njoftuar ofertuesin fitues të përkohshëm mund ta zgjasë afatin e përshtuar në paragrafin 1 të këtij neni, në rast se beson që ka nevojë të arsyeshme shtesë për të shqyrtuar ndonjë aspekt të kontratës së shitjes ose për shkak të disa rrethanave tjera që rezultojnë me shtyrje. Ky afat mund të shtyhet më së shumti edhe 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune.
3. Ofertuesi fitues i përkohshëm ka për detyrë të bëjë të gjitha përpjekjet për ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për përmbylljen e procesit të tenderimit, duke përfshirë edhe veprimet lidhur me përmbylljen e kontratës së shitjes.
4. Diskutimet ndërmjet Agjencisë dhe ofertuesit fitues të përkohshëm në lidhje me kontratën e shitjes do të shmangen maksimalisht dhe ofertuesi fitues i përkohshëm nuk duhet të kërkojë ndryshimin e çmimit të ofertës më të lartë, subjektit të ri apo asetit të tenderuar, të kushteve dhe përmbytjes së kontratës apo ndonjë veprim të ngjashëm.
5. Në rast se diskutimet ndërmjet Agjencisë dhe ofertuesit fitues të përkohshëm në lidhje me kontratën e shitjes nuk janë të suksesshme (sipas mendimit të arsyeshëm të Agjencisë) brenda afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni apo pas çfarëdo vazhdimi të afatit të tillë, atëherë Agjencia do të:
 - 5.1. ketë të drejtë që të përcaktojë pamundësinë e realizimit të shitjes së subjektit të ri apo asetit të tenderuar me ofertuesin fitues të përkohshëm;
 - 5.2. Agjencia do të njoftoj ofertuesin fitues të përkohshëm për ndërprerjen e procesit të diskutimeve edhe të gjitha shumat e paguara nga ofertuesi fitues i përkohshëm, me përjashtim të tarifës për dorëzimin e ofertës, do t'i kthehen ofertuesit fitues të përkohshëm. Në rast se Agjencia vlerëson se ofertuesi fitues i përkohshëm nuk ka bërë të gjitha përpjekjet për ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për përmbylljen e tenderimit siç është përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni, atëherë ofertuesit fitues të përkohshëm do t'i konfiskohet depozita e ofertës; dhe
 - 5.3. Agjencia do të kontaktojë me ofertuesin e radhës dhe ta ftoj nëse dëshiron të realizoj blerjen e asetit të tenderuar me çmimin e ofertës më të lartë. Në rastet e tilla, do të zbatohen në mënyrë të përshtatshme dispozitat e nenit 11 të kësaj rregullore, e të cilat kanë të bëjnë me ofertuesin e dytë më të lartë dhe ofertuesin e tretë më të lartë.

6. Kontrata e shitjes dhe çfarëdo dokumenti që ndërlidhet me të do të nënshkruhen nga një përfaqësues i autorizuar i Agjencisë sipas Aktit Themelues të Agjencisë, dhe blerësi ose një përfaqësues i autorizuar (i noterizuar) i blerësit.
7. Kontrata e shitjes dhe dokumentet e tjera që ndërlidhen me të do të nënshkruhen nga palët vetëm pas pagesës së shumës së përgjithshme të çmimit të ofertës më të lartë dhe përfundimit të pagesave dhe detyrimeve të tjera eventuale që ndërlidhen me procesin e tenderimit.

Neni 16

Rezervimi i të drejtave nga ana e Agjencisë

1. **Amendamentet në kushtet e tenderit:** Agjencia mban të drejtën për të bërë ndryshime, modifikime ose ndërprerjen e çfarëdo procedure të përcaktuar në këto rregulla për tender, pa ndonjë njoftim paraprak dhe pa kurrfarë kosto ose përgjegjësi për Agjencinë. Amendamentet në këto rregulla për tender do të nxirren me shkrim nga Agjencia dhe do të bëhen publike.
2. **Refuzimi i ofertuesit fitues:** Nëse Agjencia vërteton që informatat e dhëna në ofertën e ofertuesit fitues të përkohshëm janë të pasakta, mund të refuzojë një ofertë të ofertuesit fitues të përkohshëm dhe do të ndërpresë procedurën e tenderimit në relacion me të. Ofertuesit fitues të përkohshëm do t'i konfiskohet edhe depozita e ofertës. Në rastet e tilla, Agjencia mund të kontakton ofertuesin e radhës dhe ta ftoj atë që të deklarohej nëse dëshiron të realizojë blerjen e subjektit të ri apo asetit të tenderuar me çmimin e ofertës më të lartë. Në rastet e tilla do të zbatohen në mënyrë të përshtatshme, dispozitat e Rregullave të Tenderit, e të cilat kanë të bëjnë me ofertuesin e dytë më të lartë dhe ofertuesin e tretë më të lartë.
3. **Marrëdhënia kontraktuese**
 - 3.1. Qëllimi i Rregullave të Tenderit nuk është që të përbëjnë ndonjë marrëveshje ndërmjet Agjencisë dhe ofertuesve. Rrjedhimisht, nuk do të konsiderohet se ekziston ndonjë kontratë ndërmjet Agjencisë dhe një ofertuesi vetëm për shkak të pjesëmarrjes së ofertuesit të tillë në çfarëdo aspekti të tenderit. Nuk do të ketë asnjë raport juridik-detyrimor ndërmjet Agjencisë dhe ofertuesit fitues të përkohshëm deri në hyrjen në fuqi të kontratës së shitjes, ashtu që as Agjencia e as NSH-ja nuk do të kenë asnjë marrëdhënie detyimore me ofertuesin fitues të përkohshëm. Agjencia ka në diskrecion që të aprovoj kërkesën eventuale të Ofertuesit Fitues të Përkohshëm, për sigurimin/vendosjen e rojeve me qëllim të sigurimit dhe mbrojtjes së subjektit të ri apo asetit të tenderuar. Aprovimi i tillë nga Agjencia, nuk konstituon marrëdhënie kontraktuese midis Agjencisë dhe Ofertuesit Fitues të Përkohshëm, dhe Agjencia nuk do të mbahet përgjegjëse për asnjë shpenzim apo detyrim lidhur me këtë çështje.

3.2. Kontrata e shitjes e subjektit të ri apo asetit të tenderuar konsiderohet se hynë në fuqi në momentin e nënshkrimit të dyanshëm të saj nga ana e Agjencisë dhe nga ana e blerësit apo përfaqësuesit të autorizuar të tij me autorizim te noteri. Prej momentit të nënshkrimit të kontratës së shitjes, nga të dy palët e cekura më sipër, ofertuesi do të konsiderohet blerës i subjektit të ri apo asetit të tenderuar.

4. Gjuha

Rregullat e Tenderit janë të miratuara në gjuhën Shqipe dhe në gjuhën Serbe.

5. Mundësitë e anulimit të kontratës së shitjes

Agjencia mund të anuloj kontratën e nënshkruar të shitjes në çfarëdo periudhe në rastet si në vijim:

- 5.1. Nëse konstatohet nga organet kompetente se mjetet e përdorura nga ofertuesi fitues i përkohshëm për blerjen e subjektit të ri apo asetit të tenderuar rrjedhin në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga aktiviteti i kundërligjshëm;
- 5.2. Nëse konstatohet se gjatë procesit të tenderimit blerësi ka qenë i përfshirë në marrëveshje të fshehtë; ose
- 5.3. Nëse konstatohet se ka shmangie apo shkelje të dispozitave themelore të Rregullave të Tenderit.

Neni 17

Dispozitat kalimtare

Të gjitha rregullat dhe procedurat për asetet që janë në proces të shitjes vazhdojnë të trajtohen sipas rregullave të shitjes që kanë qenë në fuqi në datën e tenderimit.

Neni 18

Hyrja në fuqi

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore, shfuqizohet rregullorja e përgjithshme e tenderit e datës 31 korrik 2023.
2. Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Drejtorëve.

3. Për të gjitha tenderimet pas hyrjes në fuqi të kësaj rregullore do të zbatohet kjo rregullore.

Prishtinë, më 28 shtator 2023.

Mentor Hyseni



**Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit**

SHTOJCA A

“ORARI I TENDERIT”

Përmbledhja e orarit të tenderit

<i>Data</i>	<i>Nga</i>	<i>Deri</i>	<i>Kohëzgjatja</i>
Publikimi i njoftimit për tender			20 ditë
Vizitat për hulumtim paraprak			20 ditë
Dorëzimi i ofertave	10:00	12:00	2 orë
Vërtetimi/Vlerësimi i ofertave dhe identifikimi i çmimit të ofertës më të lartë	13:00	16:00-17:00	menjëherë pas hapjes së ofertave deri në hapjen e ofertës së fundit
Informimi i ofertuesve për rezultatet e tenderit			3 ditë pune
Përfundimi i Kontratës për Shitjen me ofertuesin fitues të përkohshëm			20 (njëzet) ditë pune nga data e pagesës së plotë të çmimit të shitjes

Mf.

SHTOJCA B
FORMULARI PËR DORËZIMIN E OFERTËS

- PASQYRA E ÇMIMIT -

SHAL numër:.....

Numri i njësisë dhe emri i asetit/subjektit të ri për të cilin ofertoni:.....

.....

ÇMIMI I OFERTËS

shëno çmimin e ofertës që ju synoni të paguani për asetin/subjektin e ri në shifra dhe fjalë:

€ _____, _____, _____ .⁰⁰

NË FJALË: [.....]

NË RAST SE OFERTUESI NUK PARAQET ÇMIMIN E OFERTËS EDHE ME FJALË EDHE ME SHIFRA, OFERTA E TIJ DO TË DISKUALIFIKOHET

SHËNIME:

- në rast të çfarëdo mospërputhje, në mes të shumës së paraqitur me shkronja dhe shumës së paraqitur me shifra do tëmbizotëroj **shuma e paraqitur në shkronja** dhe do të trajtohet si çmimi i ofertës.
- në rast se shuma e paraqitur me shifra dhe shuma e paraqitur me fjalë janë të palexueshme dhe/ose të pakuptueshme, oferta e ofertuesit do të diskualifikohet.
- nuk lejohet asnjë ndryshim/përmirësim i çmimit të ofertës. Agjencia do të shpallë të pavlefshme ofertën e dorëzuar e cila ka ndryshim/përmirësim të çmimit të ofertës sipas nenit 13.1 të kësaj rregullore.

INFORMATAT E KONTAKTIT TË OFERTUESIT

Emri i Ofertuesit:

(për person fizik -Emri Mbiemri / për subjekt juridik - Emri i subjektit juridik)

Adresa:

Nr. tel:Email-i:

Nr. Personal/Nr. i regjistrimit të biznesit:

DEKLARATË

Përmes kësaj deklarate unë pohoj se i kam lexuar dhe kuptuar Rregullat e Tenderit (RT) dhe garantoj se i plotësoj dhe i nënshtrohem kushteve të cekura në RT dhe nuk jam ofertues me ndalesë sipas Nenit 5 të RT-it;

Emri & Mbiemri:

Data:

Nënshkrimi:*Ky nënshkrim po ashtu konfirmon se ofertuesi pranon shënimet më lartë dhe pajtohet që të obligohet me deklaratën e bërë këtu.*

Vërejtje: Ju lutem kini parasysh se të gjitha fushat duhet të jenë të plotësuara.Në rast se ndonjëra nga informatat mbetet e paplotësuar, oferta mund të diskualifikohet.